



1322/15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.314/1 prot.

Peshkopi, më 11.04.2024

Lënda: Për vendimin nr.27, datë 05.04.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.27, datë 05.04.2024 "Për rishikimin e programit të transparencës së Bashkisë Dibër", vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 27 Datë 05 / 04 /2024

“Për rishikimin dhe përditësimin e programit të transparencës së Bashkisë Dibër”.

Mbështetur në nenet 15,18, pika 3, neni 54 shkronja “k”, të ligjit nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.143 datë 24.12.2018, “Për miratimin e Programit të Transparencës së Bashkisë Dibër”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **05.04.2024**, me 23 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të Programit të Transparencës të Bashkisë Dibër sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për përditësimin dhe zbatimin e Programit të Transparencës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **05.04.2024**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irimi Shehu

